

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Zbulohet 48-vjeçari i dyshuar për sabotimet ndaj rrjetit energjetik në Gjermani, gjenden pajisje shpërthye se pranë nënstacioneve
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/zbulohet-48-vjecari-i-dyshuar-per-sabotimet-ndaj-rrjetit-energjetik-ne-gjer-i584129
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHA


KAPUR NGA NE	5 shtator 2026, 14:19:15 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	5 shtator 2026, 15:35:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1c6d1d6698fd9c58c5216a3411d9ea11387cb138dfd227ba5055c63994474f0e
TEKSTI	72d7fd97e0b261c1662b500e20a7d725aeb8cb73c9fea62e0f4574dcadb55a20
PAMJA	0dda18fd32af9c57225be17564eabb65eef1cddbddd046e905c98af3a7db26301

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	28c4f438a1affa09c2297c5f42704a37b2a70cb901d3e226b850818013d82c75
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	82597d84b51b00d12dc8da6bd19ef563dde476bcf2b8ac3fbaec8c83c315f326
ANKORUAR	Polygon PoS · bllok 46991200
TRANSAKSIONI	0x4a6949f734bb917e86ef48a394a39f5e560c6ca7cb50992564901c0d93c74ab3
IPFS	QmcQ2vpHEy67KT56kkLrEBokuUFGqg7MP3SJ63znFCszpz



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/28c4f438a1affa09c2297c5f42704a37b2a70cb901d3e226b850818013d82c75>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

[English](#)

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



[English](#)



1 e [Protesta ne SHBA tremb Berishen - Ndryshon vendin e takimit, emigrantet: Do t'i shkojme kudo qe te jete "Perveiohet" Spanja: Shtatori nis ndryshe ne Europe, vera nuk p fundit](#)

Zbulohet 48-vjeçari i dyshuar për sabotimet ndaj rrjetit energjetik në Gjermani, gjenden pajisje shpërthyese pranë nënstacioneve



5 Shtator 2026, 17:35 Bota TEMA



Një 48-vjeçar gjerman është shpallur në kërkim në Gjermani, pasi dyshohet se qëndron pas një serie përpjekjesh sabotimi ndaj infrastrukturës energjetike në disa lende të vendit. Sipas autoriteteve, burri nga Gevelsberg, pranë Hagenit, në zonën e Ruhrit, ka marrë përsipër sulmet përmes dy letrave të dërguara në një gazetë. Në letrat e tij, ai ka përmendur si motivim “luftën kundër lëndëve djegëse fosile”.

Policia vijon kërkimet për 48-vjeçarin, ndërsa Ministri i Brendshëm i North Rhine-Westphalia, Herbert Reul, ka bërë të ditur se letrat përmbajnë informacione që, sipas autoriteteve, do të mund të ishin të njohura vetëm për personat që kanë kryer ose kanë pasur dijeni për sulmet. I dyshuari ka marrë përgjegjësinë për përpjekjet për sabotim të rrjetit elektrik pranë termocentraleve Genshwalde dhe Schwarze Pumpe, në Brandenburg, si edhe për sulme ndaj furnizimit me energji në disa zona të North Rhine-Westphalia-s.

Pajisje shpërthyese edhe në Saksoni

Rasti ka marrë përmasa më të gjera, pasi pajisje shpërthyese janë gjetur edhe pranë dy nënstacioneve elektrike në Saksoni. Sipas policisë, informacioni për këto pajisje ka ardhur gjithashtu përmes një letrë pretendimi, e cila është marrë nga autoritetet ditën e enjte. Sulmet e dyshuara janë përqendruar në North Rhine-Westphalia, Brandenburg dhe Saksoni, tre lende ku linjiti vazhdon të nxirret dhe përdoret për prodhimin e energjisë.

Autoritetet po hetojnë nëse 48-vjeçari është përgjegjës për të gjitha rastet e raportuara. Megjithatë letrat janë përdorur si një prej elementeve kryesore të hetimit, përgjegjësia e tij për sulmet ende nuk është konfirmuar përfundimisht. Pas kontrollit të banesës së të dyshuarit të premtën, oficerët kanë sekuestruar materiale shpërthyese. Më vonë, automjeti i tij është gjetur pranë pyllit Hambach. Behet fjalë për një kamion të mesëm, të cilin 48-vjeçari e kishte përshtatur si një lloj karvani. Megjithatë, vetë i dyshuari nuk është gjetur dhe vijon të jetë në arrati.

Ministri i Brendshëm i North Rhine-Westphalia, Herbert Reul, ka paralajmëruar se, pavarësisht letrave të pretendimit, autoritetet nuk mund të përjashtojnë ende mundësinë e një sabotimi të orkestruar nga një shtet i huaj. Ndërkohë, ministri federal i Brendshëm, Alexander Dobrindt, i ka cilësuar sulmet e dyshuara ndaj nënstacioneve si “ekstremizëm klimatik”, duke paralajmëruar se Gjermania mund të përballet edhe me tentativa të tjera të ngjashme.

Shqetësimi për sigurinë e infrastrukturës kritike është rritur edhe brenda sektorit energjetik gjerman. Christoph Müller, drejtori ekzekutiv i operatorit të sistemit të transmetimit Amprion, ka paralajmëruar për mundësinë e sulmeve të tjera ndaj rrjetit elektrik.

Në një intervistë për Rheinische Post, Müller ka kërkuar ndryshime ligjore për forcimin e mbrojtjes së infrastrukturës kritike, duke argumentuar se publikimi online i shumë të dhënave mbi rrjetet e energjisë dhe gazit i bën ato më të ekspozuara ndaj sabotimit. Ai ka kërkuar gjithashtu zgjerimin e mundësive për përdorimin e dronëve dhe kamerave për mbikëqyrje, ndërsa sipas tij rregullat aktuale janë shumë kufizuese. Hetimet në Gjermani vijnë, ndërsa policia po përpiqet të lokalizojë 48-vjeçarin dhe të përcaktojë nëse ai është autori i vetëm apo pjesë e një grupi më të gjerë që mund të jetë përfshirë në tentativat për sabotim.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

["Përvëlohet" Spanja: Shtatori nis ndryshe në Europë, vera nuk po largohet!](#)

16:05 Bota

[BE kopjon "Gjadrin" - Pesë vende europiane synojnë qendra deportimi jashtë BE-së, transferimet nga 2027](#)

15:45 Bota

Trump mund ta ftojë Putin në Samitin e G20 në SHBA, tërbohen liderët evropianë dhe aleatët!

15:35 Bota

Ndalohet mishi brazilian, zv.ministrja e bujqësisë: Forcojmë kontrollet në pikat kufitare! Rrezik për shtrenjtim të mishit? Kika: Prioritet siguria ushqimore

15:15 Bota / 1 koment

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.